

Prishtinë, 23 shkurt 2010

Ali HAMITI

**Zyra e Rregullatorit për Energji
Kryesues i Bordit**

Rr. Hamdi Mramori nr. 1
10000 Prishtinë, Kosovë

I nderuari z. Hamiti,

Qëllimi i kësaj letre është të shprehim protestën dhe kundërshtimin tonë dhe të 10529 qytetarëve të Kosovës me të drejte vote për ngritjen e tarifave të energjisë elektrike. Ju bëjmë apel të mos përsëritni gabimin e vitit 2009 dhe të ngarkoni edhe më shumë buxhetin e familjeve kosovare të cilat edhe ashtu po ballafaqohen me probleme dhe sfida të mëdha sociale.

Duke pasur parasysh të ardhurat për kokë banori në Kosovë dhe rrogën mesatare e cila nuk mbulon as shportën mujore të ushqimit për një familje ju kërkojmë të mos aprovoni kërkesën e KEK për ngritje të tarifës së energjisë elektrike.

Krahas argumenteve sociale që kemi cekur më lartë ka edhe argumente profesionale të cilat shkojnë kundër ngritjes së tarifës së energjisë elektrike:

Qytetarët e Kosovës paguajnë më së shumti në Ballkan për energji elektrike.


KEK-u ka pranuar vetëm në vitin 2009 afër 100 milion euro nga buxheti i Kosovës i cili grumbullohet nga parat e taksapaguesve.

KEK-u kërkon ngritjen e tarifës së energjisë elektrike për të mbuluar paaftësinë e vet për të arkëtuar të gjitha faturat e energjisë elektrike. Në këtë kontekst KEK-u po kërkon të dënohen qytetarët që paguajnë rrymën.

Furnizimi dhe shërbimet e KEK mbeten shumë të dobëta krahas nivelit të lartë të korrupsionit në këtë ndërmarrje.

Kërkojmë mirëkuptimin tuaj ndaj kësaj kërkesë.

Sinqerisht i juaji,


Ramadan Ilazi
Drejtor ekzekutiv i Lëvizjes FOL

